



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 e datës 4 qershor 2008, Rregullores MF-NR-04/2017 mbi Kriteret, Standardet dhe Procedurat e Financimit Publike të OJQ-ve si dhe neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 i datës 24.12.2021, Kryetari i Komunës merr:

VENDIM

PËR CAKTIMIN E KOORDINATORES PËR KOORDINIM ME ZYRËN PËR QEVERISJE
TË MIRË

Neni 1

Me këtë Vendim, **CAKTOHET, Pranvera Krasniqi** zyrtare në Drejtoratin për Kultur, Rini dhe Sport në Komunën e Lipjanit Koordinatore për koordinim me Zyrën për Qeverisje të Mirë /Zyrën e Kryeministrit nga Komuna e Lipjanit.

Neni 2

Zyrtarja përgjegjëse, në pajtim me dispozitat e Rregullores MF-NR-04/2017 mbi Kriteret, Standardet dhe Procedurat e Financimit Publike të OJQ-ve dhe akteve tjera ligjore dhe nënligjore përkatëse në fuqi do të kryej detyren e Koordinatores për koordinim me Zyrën për Qeverisje të Mirë /Zyrën e Kryeministrit i cili do të raportoj dhe mbledh raportet e planeve për financim publik për OJQ-të, nga Komuna e Lipjanit.

Neni 3

1. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë dhe me të njëjtin do të njoftohet Zyrtarja Pranvera Krasniqi, Zyra për Qeverisje të Mirë /Zyrën e Kryeministrit dhe DKRS-ja në Lipjani.
2. Me hyrjen në fuqi të këtij Vendimi shfuqizohet Vendimi 1Nr.016-10693 i datës 25.02.2022.

1Nr. 112/02-15/11

Lipjan, më 07.04.2025

KRYETARI I KOMUNËS

Imri Ahmeti





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 të datës 4 qershor 2008, neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 1Nr.110-623 i datës 26.09.2008 si dhe nenit 10 pika 2 të Rregullores për transportin e udhëtarëve me automjete taksi 15Nr.345/02-33605 të datës 30.06.2023, Kryetari i Komunes, nxjerr

VENDIM

PËR CAKTIMIN E LOKACIONEVE PËR VENPARKINGJE DHE NUMRIN E AUTOMJETEVE QË DO TË VENDOSEN NË KËTO VENDPARKINGJE NË QYTETIN E LIPJANIT

Neni 1

Me këtë Vendim, përcaktohen **lokacionet** për vendparkingje për automjete taksi në qytetin e Lipjanit dhe numri i automjeteve që do të vendosen në këto vendparkingje.

Neni 2

1. Lokacionet për vendparkingje për automjete taksi të evidentuara si prona komunale nga komisioni komunal dhe numri i automjeteve që do të vendosen në këto vendparkingje përcaktohen si në vijim:

1.1 **Vendparkingu nr.1**, i cili gjendet në rrugën "Skenderbeu", afër zyreve të degës së LDK-së në qytetin e Lipjanit në të cilin do të vendosen **15 automjete taksi**.

1.2 **Vendparkingu nr.2**, i cili gjendet në rrugën "Isa Olluri" në parcelën kadastrale 1932-1, ZK Lipjan në të cilin do të vendosen **15 automjete taksi**.

1.3 **Vendparkingu nr.3**, i cili gjendet në rrugën "Skenderbeu" përballë "Super Viva" në parcelën kadastrale nr. 1991-0 ZK Lipjan në të cilin do të vendosen **3 automjete taksi**.

1.4 **Vendparkingu nr.4**, i cili gjendet në Aeroportin Ndërkombëtar "Adem Jashari" në parcelën kadastrale 1926-1, ZK Vrellë e Goleshit në parcelën kadastrale 1932-1, ZK Lipjan në të cilin do të vendosen **110 automjete taksi**

1.5 **Vendparkingu nr.5**, i cili gjendet në rrugën "Xhavit Kozhani", në parcelën kadastrale nr. 1791-0, ZK Lipjan në të cilin do të vendosen **15 automjete taksi** (ruga Xhavit Kozhani

bëhet rrugë njëkahore siq ka qenë më herët, në anën e majtë në njërën korsi me gjatësi rreth 75 m nga kryqëzimi me rrugën "Skenderbeu" deri te hyrja te Tregu .

1.6 Vendparkingu nr.6, i cili gjendet në rrugën "Shën Flori" (në anën e djathtë nga rrethrrrotullimi) në parcelën kadastrale 1991-0, ZK Lipjan në të cilën do të vendosen 15 automjete taksi.

1.7 Vendparkingu nr. 7 i cili gjendet në rrugën "Gjergj Fishta" në parcelat kadastrale nr.1794-0 dhe 1795-0, ZK Lipjan (nga semaforat me gjatësi rreth 40 m) në të cilin do të vendosen 8 automjete taksi.

1.8 Vendparkingu nr. 8, i cili gjendet në rrugën "Lidhja e Prizrenit" në parcelën kadastrale nr.1926-1 ZK Lipjan përballë nënkalimit ana e djathtë) në të cilin do të vendosen 6 automjete taksi.

Neni 3

Lokacionet e cekura në nenin 2 të këtij Vendimi mund të mund të ndyshohen me Vendim tjetër varësisht nga nevojat ose planet urbane të Komunës.

Neni 4

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Drejtorati për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim dhe Drejtorati për Inspektorat i Komunës së Lipjanit.

Neni 5

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Komunës.

Vendimi i dërgohet:

Drejtoratit për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim,

Drejtoratit për Inspektorat,

Në arhivë

1Nr. 353/01-15441

Lipjan, më 07.04.2025

KRYETARI I KOMUNËS

Imri Ahmeti





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 e datës 4 qershor 2008, nenit 85 të Ligjit Nr.08/L-197, si dhe neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 i datës 24.012.2021, Kryetari i Komunës nxjerr

VENDIM
PËR FORMIMIN E KOMISIONIT DISIPLINOR
PËR STAFIN SHËNDETËSOR

Neni 1

Me këtë Vendim, formohet Komisioni disiplinor për stafin shëndetësor në kuadër të Drejtoratit për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale të Komunës së Lipjanit, në këtë përbërje:

1. Albert Mustafa, Kryesues
2. Dr. Arjeta Arifi, anëtare
5. Shie Lekaj, Zyrtare e lartë për personel ,anëtare

Neni 2

Komisioni disiplinor do ti kryej detyrat dhe përgjegjësitë konform kompetencave të përcaktuara me dispozitat e nenit 85 , 55, 56, 57,58 ,59, 60 dhe 61 të Ligjit Nr.08/L-197 për zyrtarët publik dhe akteve tjera përkatëse nënligjore .
Mandati i Komisionit është dy vjeçar.

Neni 3

Punët administrativo-juridike për Komisionin do ti kryej Drejtorati për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale.

Neni 4

Vendimi hyn në fuqi menjëherë dhe me të njëjtin do të njoftohet Drejtorati për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale, Kryesuesi dhe anëtarët e Komisionit .

INr. 020/1-21461
Lipjan, më 28.04.2025

KRYETARI I KOMUNËS

Imri Ahmeti





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28 e datës 4 qershor 2008, neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 i datës 24.12.2021, nenit 9 të Rregullores për ndarjen e subvencioneve 15Nr.011-43474 e datës 28.06.2019, Rregullores së Kuvendit të Komunës me Nr.15-110/04-11057 e datës 28.02.2023 për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për ndarjen e subvencioneve 15Nr.-011-43473 e datës 28.06.2019, shpalljes publike për aplikim Nr.12-320/01-11658 e datës 14.03.2025, Kryetari i Komunës merr:

VENDIM
PËR FORMIMIN E KOMISIONIT PËR SHQYRTIMIN DHE VLERËSIMIN E
KËRKESAVE TË FERMERËVE

Neni 1
Përbërja

Me këtë Vendim, formohet Komisioni për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave të fermerëve konform shpalljes publike për aplikim Nr.12-320/01-11658 e datës 14.03.2025 të Drejtoratit për Bujqësi dhe Pylltari për implementimin e projektit : subvencionimi i qumështit për litër, (në vazhdim të tekstit Komisioni), në këtë përbërje:

1. Afrim Sadiku, Drejtorati për Bujqësi dhe Pylltari, Kryesues
2. Hazbi Ademi, Zyra e Kryetarit të Komunës, anëtar
3. Shefki Sadiku, Drejtorati për Administratë, anëtar

Neni 2
Detyrat, përgjegjësitë e Komisionit

Detyrat dhe përgjegjësitë e Komisionit janë si vijon:

- Bën shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave/aplikacioneve për ndarje të subvencioneve për fermerë prodhues të qumështit përkatësisht për implementimin e projektit : subvencionimi i qumështit për litër, të cilët kanë aplikuar sipas shpalljes publike për aplikim Nr.12-320/01-11658 e datës 14.03.2025 të Drejtoratit për Bujqësi dhe Pylltari, brenda afatit prej 30 ditë pune pas pranimit të këtij Vendimi në pajtim me dispozitat e Rregullores për ndarjen e subvencioneve 15Nr.011-43474 e datës 28.06.2019, Rregullores së Kuvendit të Komunës me Nr.15-110/04-11057 e datës 28.02.2023 për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për ndarjen e subvencioneve 15Nr.-011-43473 e datës 28.06.2019 si dhe shpalljes publike për aplikim Nr.12-320/01-11658 e datës 14.03.2025.
- I rekomandon Kryetarit të Komunës listën e përfituesve në përputhje me kriteret e përcaktuara në shpalljen publike për ndarjen e subvencioneve dhe në pajtim me dispozitat e Rregullores për ndarjen e subvencioneve.

- Komisioni mban procesverbal nga mbledhjet e tij i cili duhet të nënshkruhet nga anëtarët e Komisionit.
- Rekomandimet e Komisionit merren me shumicë të votave nga numri i përgjithshëm i anëtarëve të Komisionit.
- Komisioni pas shqyrtimit të kërkesave publikon listën preliminare të përfituesve ku palët e pakënaqura kanë drejtë ankese në Komisionin e ankesave brenda afatit 15 ditor nga dita e publikimit të listës.
- Pas përfundimit të procedurave të ankesave, Komisioni vlerësues shpallë listën finale nëse ka ndryshime nga ajo preliminare varësisht nga Vendimi i Komisionit të ankesave.

Neni 3

Hyrja në fuqi

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit ndërsa me kopjen e këtij Vendimi të njoftohen Drejtorati për Bujqësi dhe Pylltari, Kryesuesi dhe anëtarët e Komisionit.

INr. 020/04-14246

Lipjan, 02.04.2025

KRYETARI I KOMITETIT

Imri Ahmeti





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 e datës 4 qershor 2008, neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 i datës 24.01.2021 dhe nenit 6 dhe 8 të Rregullores për transportin e udhëtarëve me automjete taksi 15Nr.345/02-33605 e datës 30.06.2023, Kryetari i Komunës merr:

VENDIM

PËR FORMIMIN E KOMISIONIT PËR SHQYRTIMIN E APLIKACIONEVE TË OPERATORËVE
PËR USHTRIMIN E VEPRIMTARISË PËR TRANSPORTIN E UDHËTARËVE ME AUTOMJETE
TAKSI DHE VERIFIKIMIN E AUTOMJETEVE

Neni 1

Përbërja

Formohet, Komisioni për shqyrtimin e aplikacioneve të operatorëve për ushtrimin e veprimtarisë për transportin e udhëtarëve me automjete taksi dhe verifikimin e automjeteve, (në vazhdim të tekstit Komisioni) të cilët kanë aplikuar sipas Njoftimit publik 13Nr.-111-01-15513 të datës 07.04.2025, në përbërje si vijon:

1. Daut Reçica, Kryesues
2. Salihe Marevci, anëtare
3. Rafete Retkoceri, anëtare
4. Rrahman Olluri, anëtar
5. Bujar Curri, anëtar

Neni 2

Detyrat dhe përgjegjësitë e Komisionit

1. Komisioni për shqyrtimin e aplikacioneve të operatorëve sipas njoftimit të cekur publik, në afat prej 45 dite nga dita e pranimit të vendimit për formimin e komisionit, shqyrton aplikacionet, verifikon automjetet dhe harton Raportin me listën e operatorëve të cilët i plotësojnë kushtet për dhënien e Licencës, të cilin ia dërgon Drejtoratit për Shërbime Publike Mbrojtje dhe Shpëtim
2. Punët ndihmëse administrative dhe teknike për Komisionin do ti kryej Drejtorati për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim.

Neni 3

Hyrja në fuqi

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe me të njëjtin të njoftohen Kryesuesi dhe anëtarët e Komisionit.

1Nr. 020/01-14204/2
Lipjan, më 23.04.2025

KRYETARI I KOMUNËS

Imri Ahmeti





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13, 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.28 e datës 4 qershor 2008, nenit 8 të Rregullores MF - NR - 04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve, si dhe neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 i datës 24.12.2021, Kryetari i Komunës merr:

**VENDIM
PËR FORMIMIN E KOMISIONIT VLERËSUES**

**Neni 1
Përbërja**

Me këtë Vendim formohet Komisioni vlerësues për shqyrtimin dhe vlerësimin e aplikacioneve për financimin e projekteve/programeve të OJQ-ve –, që kanë aplikuar sipas thirrjes publike Festivali i këngës për fëmijë “Lipjani këndon” Nr.5-453/01-12425 të datës 19.03.2025, në përbërje si vijon:

1. Tramor Shamolli, Drejtorati për Kulturë, Rini dhe Sport, Kryesues
2. Albulena Gashi, Drejtorati për Kulturë, Rini dhe Sport, anëtare
3. Laureta Ahmeti, Drejtorati për Buxhet dhe Financa, anëtare
4. Ernesa Kërpuzi ,nga OJQ-të anëtare
5. Fatbardha Drnogllava , në cilësinë e ekspertit të jashtëm, anëtare
6. Fadil Krasniqi, , Drejtorati për Kulturë, Rini dhe Sport, anëtarë rezervë

**Neni 2
Detyrat dhe përgjegjësitë e Komisionit**

Komisioni do të bëjë shqyrtimin dhe vlerësimin e të gjitha aplikacioneve për financimin e projekteve/programeve të OJQ-ve që kanë aplikuar sipas thirrjes publike Festivali i këngës për fëmijë “Lipjani këndon” Nr.5-453/01-12425 të datës 19.03.2025,të shpallur nga Drejtorati për Kulturë, Rini dhe Sport. Komisioni do t’i kryejë detyrat konform dispozitave të Rregullores MF - NR - 04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve.

**Neni 3
Hyrja në fuqi**

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe me të njëjtin do të njoftohen Drejtorati për Kulturë Rini dhe Sport, Kryesuesi dhe anëtarët e Komisionit.

1Nr. 020/01-20255
Lipjan, më 22.04.2025

KRYETARI I KOMUNËS
Imri Ahmeti





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13, 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.28 e datës 4 qershor 2008, nenit 8 të Rregullores MF - NR - 04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve, si dhe nenve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 i datës 24.12.2021, Kryetari i Komunës merr:

VENDIM
PËR FORMIMIN E KOMISIONIT VLERËSUES

Neni 1
Përbërja

Me këtë Vendim formohet Komisioni vlerësues për shqyrtimin dhe vlerësimin e aplikacioneve për financimin e projekteve/programeve të OJQ-ve – që kanë aplikuar sipas thirrjes publike “Rinia Fest Lipjan 2025” Nr.5-453/01-12423 të datës 19.03.2025, në përbërje si vijon:

1. Pranvera Krasniqi, Drejtorati për Kulturë, Rini dhe Sport, Kryesuese
2. Ramiz Gashi, Drejtorati për Kulturë, Rini dhe Sport, anëtar
3. Albulena Salihu, Drejtorati për Buxhet dhe Financa, anëtare
4. Euresa Karpuzi, nga OJQ-të, anëtare
5. Fatbardha Drnogllava, në cilësinë e ekspertit të jashtëm, anëtare dhe
6. Trimor Shamolli, Drejtorati për Kulturë, Rini dhe Sport, anëtar rezervë

Neni 2
Detyrat dhe përgjegjësitë e Komisionit

Komisioni do të bëjë shqyrtimin dhe vlerësimin e të gjitha aplikacioneve për financimin e projekteve/programeve të OJQ-ve që kanë aplikuar sipas thirrjes publike “Rinia Fest Lipjan 2025” Nr.5-453/01-12423 të datës 19.03.2025 të shpallur nga Drejtorati për Kulturë, Rini dhe Sport. Komisioni do t’i kryejë detyrat konform dispozitave të Rregullores MF - NR - 04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve.

Neni 3
Hyrja në fuqi

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe me të njëjtin do të njoftohen Drejtorati për Kulturë Rini dhe Sport, Kryesuesi dhe anëtarët e Komisionit.

1Nr. 020/01-20254
Lipjan, më 22.04.2025

KRYETARI I KOMUNËS

Imri Ahmeti





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 e datës 4 qershor 2008, nenit 44 të Ligjit Nr.04/L-027 për Mbrojtje nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë e tjera, nenit 17 paragrafi 7 të Rregullores (QRK) nr.25/2020 për metodologjinë e hartimit të vlerësimit të rrezikshmërisë si dhe neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15 Nr.110-78095 të datës 24.12.2021, Kryetari i Komunës merr :

VENDIM

PËR FORMIMIN E GRUPI PUNUES PËR HARTIMIN E DRAFT-PLANIT PËR
VLERËSIMIN E RREZIQEVE NGA FATKEQËSITË NATYRORE DHE FATKEQËSITË
TJERA NË TERRITORIN E KOMUNËS SË LIPJANIT

Neni 1

Përbërja

Formohet, grupi punues për hartimin e Draft-Planit për vlerësimin e rreziqeve nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera në territorin e Komunës së Lipjanit, në përbërje si vijon:

1. Burim Rrustemi, Kryesues
2. Rafete Retkoceri, anëtare
3. Gafurr Hetemi, anëtar
4. Vlora Krasniqi, anëtare
5. Albert Mustafa, anëtar
6. Bekim Zaskoku, anëtar
7. Jalldyze Gashi, anëtare
8. Afrim Sadiku, anëtar
9. Behar Mjeku, anëtar
10. Enver Elshani, anëtar
11. Brahim Duriqi, anëtar
12. Fatmir Bytyqi, bashkëpunëtor-ekspert i jashtëm

Neni 2

Detyrat dhe përgjegjësitë e grupit punues

1. Grupi punues ka për detyrë që në pajtim me dispozitat ligjore përkatëse të hartojë Draft- Planin për vlerësimin e rreziqeve nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera në territorin e Komunës së Lipjanit.

2. Grupi punues duhet t'i ndjekë procedurat e konsultimit publik sipas dispozitave ligjore përkatëse dhe të mbajë takim të hapur publik duke mbajtur procesverbal në bashkëpunim me Zyrtaren përgjegjëse për konsultim publik.
3. Pas finalizimit të Draft- Planit, grupi punues është i obliguar që draftin final përmes Kryetarit të Komunës ta dërgojë paraprakisht në AME -Agjencia e Menaxhimit Emergjent për shqyrtim profesional dhe përmbajtësor dhe pas marrjes së opinionit nga AME e procedon për miratim në Kuvendin Komunal.
4. Punët administrative – teknike për grupin punues do t'i kryej Drejtorati për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim.

Neni 3
Hyrja në fuqi


Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe me të njëjtin të njoftohet, Kryesuesi dhe anëtarët e grupit punues.

Me hyrjen në fuqi të këtij Vendimi shfuqizohet Vendimi për formimin e grupit punues për hartimin e Draft-Planit për vlerësimin e rreziqeve nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera në territorin e Komunës së Lipjanit 1Nr.020/01-64449 i datës 16.11.2023.

1Nr. 020/01-21360
Lipjan, më 28.04.2025

KRYETARI I KOMUNËS

Imri Ahmeti





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13, 58 dhe 68 par 68.4 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 të datës 4 qershor 2008, neneve 40, 41 dhe 67 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 i datës 24.12.2021, Udhëzimit administrativ (MAPL) nr.04/2023 për Administratë të hapur në Komuna, si dhe Rregullores për Transparencën në Komunën e Lipjanit 15Nr.-016/01-63314 e datës 26.12.2024, Kryetari i Komunës nxjerr:

VENDIM

MBI KONSULTIMIN E PUBLIKUT PËR PROJEKT – RREGULLOREN PËR TAKSA KOMUNALE

Neni 1

Për të realizuar konsultimet dhe pjesëmarrjen e publikut, në miratimin e akteve nga kompetenca e Komunës, të publikohet në WebFaqen e Komunës:

Projekt – Rregullorja për Taksa Komunale.

Neni 2

Vërejtjet dhe sugjerimet për Projekt-Rregulloren për Taksa Komunale mund t'i dërgohen Komisionit për hartimin e Projekt-Rregullores për Taksa Komunale ose në email adresën vlora.r.krasniqi@rks-gov.net, më së largu me datë 02.05.2025.

Neni 3

Ky Vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet në Webfaqen e Komunës.

1Nr. 434/01-18298
Lipjan, më 16.04.2025





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Na osnovu članova 13, 58 i 68 stav 68.4 Zakona o Lokalnoj Samoupravi Br.03/L-040, Službena Novina Republike Kosova, br.28 dt. 4 juni 2008, članova 40, 41 i 67 Statuta Opštine Lipljan 15Br.110-78095 dt. 24.12.2021, Administrativno Upustva (MUP) Br.04/2023 za u pravu open u open u opštini, Uredba o Transparentnosti u Opštini Lipljan, Br. 15-353-35739 dt.30.06.2021, Predsednik Opštine donosi:

ODLUKA

O JAVNOJ KONSULTACIJI ZA PROJEKT - UREDBU ZA OPŠTINSKIM TAKSAMA

Član 1

U cilju sprovođenja konsultacija i učešća javnosti, u usvajanju akata iz nadležnosti Opštine, objaviti na Websajt Opštine:

Projekt -. Uredbu Za Opštinskim Taksama

Član 2

Primedbe i sugestije na ovaj Projekt – Uredbu Za Opštinskim Taksama mogu se poslati radnoj Komisiji za izradu Projekt – Uredbu Za Opštinskim Taksama na email adresu: vlora.r.krasniqi@rks-gov.net naj kasnije do 02.05.2025.

Član 3

Ova Odluka stupa na snagu danom usvajanja i biće objavljena na Websajt Opštine.

1Br: 434/01-18898
Lipljan, 16.04.2025

PREDSEDNIK OPŠTINE
Imri Ahmeti



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15 Nr.110-78095 të datës 24.12.2021, nenit 13 të Rregullores për ndarjen subvencioneve 15Nr.-011-43473 e datës 28.06.2019, Rregullores për varrezat, ofrimin e shërbimeve të varrimit, rregullimin dhe mirëmbajtjen e tyre, 15Nr.011-71878 të datës 27.11.2018, nenit 1 të Rregullores 15Nr.011-15426 të datës 17.03.2021 për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për varrezat, ofrimin e shërbimeve të varrimit, rregullimin dhe mirëmbajtjen e tyre, 15Nr.011-71878 të datës 27.11.2018, Vendimit të Kuvendit të Komunës për subvencionimin e shpenzimeve për shërbimet e varrimit të qytetarëve me vendbanim të përhershëm në territorin e Komunës së Lipjanit 15Nr.400/01-16372 të datës 31.03.2023 si dhe Marrëveshjes së Mirëkuptimit për subvencionimin e shpenzimeve për shërbimet e varrimit Nr.1-400/01-23306 e datës 05.05.2023, Kryetari i Komunës nxjerr:

VENDIM

PËR NDARJEN E MJETEVE FINANCIARE BASHKËSISË ISLAME NË LIPJAN PËR SUBVENCIONIMIN E SHËRBIMEVE TË VARRIMIT

Neni 1

I ndahet shuma e mjeteve në vlerë prej **9,240.00€**, (nëntë mijë e dyqindë e katërdhjetë euro) Bashkësisë Islame dega në Lipjan, sipas kërkesës së tyre Nr.1-400/01-14860 e datës 04.04.2025, për subvencionimin e shërbimeve të varrimit për 33 raste të vdekjes, të cilat kanë ndodhur në muajin mars të vitit 2025 me nga 280 euro për secilin rast $33 \times 280 = 9,240.00€$, të cilat shërbime kryhen nëpërmjet BI - dega në Lipjan në pajtim me dispozitat e Marrëveshjes së Mirëkuptimit për subvencionimin e shpenzimeve për shërbimet e varrimit e lidhur në mes të Komunës së Lipjanit dhe Këshillit të Bashkësisë Islame dega në Lipjan Nr.1-400/01-23306 e datës 05.05.2023.

Neni 2

Shuma e cekur nga neni 1 do të paguhet nga mjetet e buxhetit të Komunës së Lipjanit për vitin 2025, pozicioni buxhetor - subvencionet e planifikuara për Zyrën e Kryeatrit të Komunës në xhirollogarinë bankare të Këshillit të Bashkësisë Islame në Lipjan nr.1719200019037882 në NLB.

Neni 3

Obligimet e Këshillit të Bashkësisë Islame rreth kryerjes së shërbimeve të varrimit, afatet e raportimit, dokumentacioni dhe çështje tjera që ndërlidhen me obligimet e ndërsjella mes palëve janë të përcaktuara me dispozitat e Marrëveshjes së cekur në nenin 1 të këtij Vendimi.

Neni 4

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Drejtorati për Buxhet dhe Financa dhe Zyra e Kryetarit të Komunës.

Neni 5

Vendimi hyn në fuqi menjëherë dhe me të njëjtin do të njoftohet Këshilli i Bashkësisë Islame i Kosovës dega në Lipjan.

1Nr.400/01-14860
Lipjan, më 07.04.2025

KRYETARI I KOMUNËS

Imri Ahmeti





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 të datës 4 qershor 2008, nenit 9 par. 9 të Rregullores MF –Nr.02/2013 për menaxhimin e pasurisë jofinanciare në organizatat buxhetore, neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15 Nr.110-78095 i datës 24.12.2021 si dhe Procesverbalit të Komisionit për vlerësimin e pasurisë komunale Nr.02-400/01-19016 i datës 16.04.2025, Kryetari i Komunes, nxjerr

VENDIM
PËR TJETËRSIMIN-ASGJËSIMIN E OBJEKTIT TË VJETËR -BARAKËS

Neni 1

TË ASGJËSOHET- RRËNOHET, Objekti i vjetër –Baraka në pronësi komunale me ID të artikullit në SIMFK 2011000000008930 duke u bazuar në Procesverbalin e Komisionit për vlerësimin e pasurisë komunale Nr.02-400/01-19016 i datës 16.04.2025.

Neni 2

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Drejtorati për Administratë dhe Drejtorati për Prokurim.

Neni 3

Vendimi hyn në fuqi menjëherë dhe me të njëjtin do të njoftohen Drejtorati për Administratë, Drejtorati për Prokurim dhe Zyrtari për pasuri.

INr. 351/09-19607
Lipjan, më 17.04.2025

